




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. Prot. 01-4307/14
 Br. Prot. 01-4307/14
 Prot No.
 Nr. i faq.
 Data 20.11.2014
 Broj stranica 02
 Datum
 Nr. pages
 Date
 PRISTINE



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|------------------------|---|
| DATË/A: | 20.11.2014 |
| REFERENC-Ë: | AKK- DPK- DPKPP |
| PËR/ZA/TO: | z. Xhevat SIMNICA Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Komunën e Prishtinës |
| CC: | z. Shpend AHMETI Kryetar i Komunës së Prishtinës |
| NGA/OD/FROM: | z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin me titull "Krijimi i kadastrit të përvojave nëntokësore" |

I nderuari z. Simnica,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me "Krijimi i kadastrit të përvojave nëntokësore" me numër prokurimi: 616-14-181-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull " Krijimi I kadastrit të përvojave nëntokësore" me numër prokurimi: 616-14-181-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetimi

Komuna e Prishtinës përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me "**Krijimi i kadastrit të përvojave nëntokësore**", me numër prokurimi: 616-14-181-221 i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.12.11.2014 në Procedurën e Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) pranë, Agjencisë kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës. Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar faktet si në vijim:

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Agjencia ka vërejtur se si kriter për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka caktuar kriterin *Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*, ndërsa si nën kritere i ka vendosur **1.** Çmimin të cilin e ka peshuar me 50 %, **2.** Përvoja specifike dhe profesionale e stafit lidhur me detyrat e kërkuara me peshë prej 25 %, **3.** Metodologjia dhe plani i punës për realizimin e projektit të cilin e ka peshuar me 25 %.

Lidhur me nën kriteret 2 dhe 3 Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se nën kritere të tilla nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues.

Autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës, sipas legjislacionit të prokurimit publik kritereve të përzgjedhjes nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës, andaj konsiderojmë se nën kriteret e vendosura si më lartë nuk janë kritere të matshme dhe do duhej të caktoheshin si kritere minimale për kualifikim.

Gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit, Agjencia ka vërejtur se Njësia e Kërkesës i ka propozuar gjithashtu edhe kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënien e kontratës e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, ku përcaktohen qartë funksionet e njësisë kërkuese dhe njësisë së prokurimit, andaj secila duhet veproj konform përgjegjësive që ka.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës të LPP, nenin 9 Funksionet e njësisë së Kërkesës, nenin 23 Kriteret e përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !